



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV-të
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 148/14
Prishtinë, më 26.03.2014, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Muhamet Mustafa, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama dhe Duda Balje.

Mungoi: Albana Fetoshi.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Naim Abazi- kryetar i KPMSHK, Islam Cakaj dhe Miran Zeneli nga KPMSHK, Ismet Krasniqi – Sekretar i Kuvendit, Emrush Haxhiu dhe Istret Azemi-KK,

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e komisionit.

R e n d i i d i t ë s:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 12.03.2014 dhe 19.03.2014;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë për Linjën Kreditore për Fondin e Sigurimit të Depozitave në Kosovë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim;
4. Shqyrtimi i amendamentit plotësues të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me Projektligjin nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti;
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2013;
6. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2015-2017;
7. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja:konstatoi se rendi ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt.12.03.2014 dhe 19.03.2014

Kryetarja:konstatoi se procesverbalet miratohen pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë për Linjën Kreditore për Fondin e Sigurimit të Depozitave në Kosovë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Kryetarja: theksoi se është fjala për një marrëveshje që ka të bëjë me sigurimin e fondeve të depozitave me vlerë prej 10 milion euro. Qëllimi i kësaj marrëveshje ka qenë të përkrahet fondi i depozitave dhe të mundësohet që me u rrit vlera e sigurimeve nga 2 milion në 3 milion euro. Kjo është bërë me qëllim të mundësisë në qasjen e fondeve, në rast të dështimit të ndonjë banke. Nënshkruesi edhe përfituesi i kësaj marrëveshje është fondi i sigurimit të depozitave në Kosovë, ndërkaq garantues e marrëveshjes është Qeveria, respektivisht ministria e financave në pajtim me ligjin për borgjet publike.

Pas sqarimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë për Linjën Kreditore për Fondin e Sigurimit të Depozitave në Kosovë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

4. Shqyrtimi i amendamentit plotësues të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me Projektligjin nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti

Kryetarja: theksoi se amendamenti plotësues i propozuar nga komisioni funksional nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

Kryetarja, konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Amendamenti plotësues i Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me Projektligjin nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2013

Kryetarja: Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka dorëzuar raportin financiar të plotësuar në formën

standarde, dhe nga raporti shohim se ky institucion i pavarur ka shpenzuar rreth 98% të buxhetit, 98.84% për paga dhe mëditje, 98.04% për mallra dhe shërbime dhe 84.93% për shërbime komunale.

Naim Abazi: Këshilli i pavarur mbikëqyrës ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor dhe financiar. Buxheti vjetor i aprovuar për vitin 2013 ka qenë 251,716 euro. Nuk ka pas ndryshime sa i përket vijave buxhetore, buxheti i shpenzuar për paga dhe mëditje ka qenë 183,687 euro, sa i përket mallra e shërbimeve janë shpenzuara janë 11,590,29 euro, ndërsa shpenzimet komunale janë shpenzuara 3,821 euro, shpenzimet kapitale këshilli i pavarur mbikëqyrës nuk ka pasur.

6. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2015-2017

Kryetarja: theksoi se nga materiali që përgatit administrata e Kuvendit, shohim se ka ndryshime nga viti 2014 në vitin 2015, kemi rritje në disa pozicione, për çka kërkohet nga sekretari dhe stafi i tij të na arsyetojnë këto ndryshime. Për renovim të ndërtesës prapë janë parapa 310,000 euro, për mallra dhe shërbime kërkohet buxhet shtesë prej 76,000 eurove, te investimet kapitale me na sqarue sa janë të arsyeshme këto ndryshime. Është paraparë prapë shtimi i numrit të punësuarve dhe është mirë të kemi sqarime për këto planifikime. Po ashtu brenda në material janë shumë gabime teknike, si referimi gabim i viteve, disa shuma janë kalkuluar gabimisht, si dhe kemi emërtim të projektit, ndërsa mungon shuma. Kërkohet që këto gabime të përmirësohen në mënyrë që materiali që do të procedohet për Kryesi, të jetë i përmirësuar.

Naser Osmani: nga materiali shohim se buxheti te pagat e deputetëve nuk ka ndryshime në mes viteve 2014 dhe 2015. Sekretar, ju e dini se ligji për privilegjet e deputetëve është në procedurë të aprovimit dhe ka koston buxhetore të vlerësuar dhe është dashur që këto shpenzime të parashihen në KASH e Kuvendit.

Ismet Krasniqi: sqaroi se KASH i Kuvendit për periudhën 2015-2017 përfshinë të gjitha kërkesat për periudhën me të cilat mbulohen shpenzimet buxhetore. Administrata e Kuvendit edhe komisionet punojnë në bazë të akteve aktuale që janë në fuqi. Sa i përket ligjit për deputetë e dimë që është në procedurë por i pa miratuar, në këtë drejtim pa e qenë i miratuar një akt nuk mundemi me e definua koston e implementimit të tij.

Naser Osmani: ne po flasim për planifikim të shpenzimeve, edhe planifikimi që është bërë për renovimin e objektit konsiderohet planifikim, pavarësisht a investohen ato mjete. Ligji për deputetë ekziston sepse gjykata e ka kthye që ka të bëjë vetëm me pensionet suplementare, dhe në ndërkohë është punuar është punuar në të.

Ismet Krasniqi: thekson se me gjithë konsideratën se ligji për deputetë në mënyrën se i ka ardhur, pak po paragjykojmë pjesën që e ka anuluar gjykata kushtetuese nuk është korrigjuar, por prapë ka me qenë i refuzuar me atë pjesën, sepse ligji prekë në barazinë sociale nuk është mirë ne me definua këtë, pasi që e definon seanca. Por jam i informuar nga BE-ja se 250,000 euro për hartimin e ligjit për Kuvendin e Kosovës edhe Rregulloren e kuvendit. Pjesë e ligjit të kuvendit ka me qenë ligji II deputetëve, çështja e agjencioneve të pavarura dhe pjesa e administratës. Megjithatë ne mundemi me dhënë një shumë të koston për ligjin për deputetë. Sa i përket përmbajtjes së KASH-it, shohim se prej viti 2015 e 2014 kemi një rritje prej shumës 700,970.299 euro. Shuma për paga dhe mëditje prej 411,000 euro ka të bëjë me implementimin e rritjes së pagave prej 25% dhe punësimin e 5 zyrtarëve të rij në administratën e Kuvendit në vitin 2015, te mallrat dhe shërbimet janë 76,000 euro rritje e cila shpërndahet në këto aktivitete, 30,000 euro sipas ligjit për financimin e subjekteve politike, që kuvendi zhvillon procedurat e

zgjedhjes së 10 auditorëve. Janë paraparë 710,000 euro për sigurimin e ndërtesës, 11,000 euro janë për mirëmbajtjen e pajisjeve aktuale të kuvendi. Te kategoria investime kapitale është një rritje prej 310,000 euro për krijimin e qendrës së të dhënave prej ekzistimit të kuvendit e deri më sot.

Latif Gashi: thekson se realisht te shtimi i numrit të punëtorëve, në kuadër të reformës në administratë publike, ne duhet të orientohejmë kah zvogëlimi i numrit të punëtorëve në administratën shtetërore në përgjithësi dhe jo kah rritja. Ne institucione kemi tepërcë teknologjike, çdo vend modern në botë kur shkon dikush në pension nuk punësohet dikush i ri, por shikohen mundësimet e brendshme. Gati 40% e buxhetit të Kosovës po shkon për paga e mëditje dhe ju kisha lutur që në planifikimet në të ardhmen duhet pasur kujdes në rritjen e numrit të punëtorëve, që po reflekton edhe në rritjen e buxhetit për paga dhe mëditje.

Ismet Krasniqi : çështja e rritjes së punëtorëve është një dukuri e gjitha parlamenteve dhe në këtë kontekst administrata e kuvendit të Kosovës është në zhvillim e sipër dhe se kemi nevojë akoma me e fuqizue stafin, i cili shkon në favor të deputetëve. Kemi pas nevojë për në zyre për hulumtime e kemi krijuar, kemi nevojë për një zyre ligjore që duhet të krijohet. Ne kemi 0,4 punëtor për një deputetë dhe gjithsej janë 52 punëtor në departamentin ligjor dhe është një mungesë e stafit për shërbimin e deputetëve, krahas parlamenteve tjera se si i kanë të rregulluar stafin për deputetë.

Latif Gashi: jeni sekretar i kuvendit dhe duhet me reflektue pozitivisht e kuadrat që pranohen me kanë ekspert e jo me raste sociale dhe ju kisha lutë me bërë përzgjedhjet e ekspertëve dhe të pandikuar nga politika.

Xhevdet Neziraj: në krahasim me parlamente tjera, në të gjitha legjislaturat kemi pak mbështetje prej stafit, dhe ne na duhet me u gjet vetë dhe me i shikue materialet. Po është mirë me e pas edhe një egjiptian në Kuvendin e Kosovës, pasi që janë të punësuar prej komuniteteve tjera, si serb, turq është mirë me kanë edhe një egjiptian, se po thonë se nuk ka kuadra, që ë fakt ka pasur por nuk i keni pranuar , them se po i shkelni kriteret sepse ka jurista e ekonomista edhe më të përgatitur se që janë në kuvend.

Kryetarja: pajtohem me të gjitha që u ngritën nga deputetë dhe i thëmë sekretarit se duhet të forcohet stafi i komisionit për buxhet, nuk është krejt e njëjtë sikur të shqyrtohen çështjet që kanë të bëjnë me shifra, e sikur komisionet tjera që e kanë ka një mbledhje në muaj.

Pas diskutimeve dhe sugjerimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të miratojë Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2015-2017, dhe t'i rekomandojë Ministrisë së Financave, që të njëjtën ta përfshijë në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2015-2017.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion

Kryetarja: theksoi se projektligji dhe amendamentet e komisioni funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Kryetarja, konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

8. Të ndryshme:

8.1. Kryetarja: kërkojë nga grupi punues, i caktuar për shqyrtimin e Projektligji për Inspektoratin e Doganave dhe ATK-së që të vazhdoj punën në shqyrtimin e projektligjit dhe raportin me rekomandime ta procedojë në komision, në mënyrë që të radhisim për mbledhjen e radhës.

8.2. Kryetarja: ju e dini që e kemi miratuar ligjin për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo bankare. Pjesë që ka të bëjë me institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, nga Gjykata Kushtetuese janë konsideruar se janë në kundërshtim me Kushtetutën. Është mirë që ne si komision të jemi hartues të Projektligjit për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, ku do ta bëjmë një punë të përbashkët me BQK-në, të cilët janë të involvuar në problematikën e këtyre institucioneve. Nëse ju pajtoheni, u propozoj që të formojmë një grupi punues për hartimin e Projektligjit për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare

Hykmete Bajrami: unë mendoj se nuk kemi kohë me u marr me hartimin e ligjit, por unë kisha propozue që Banka Qendrore si sponzorizuese e ligjit të pastroj apo të heq pjesën që e ka vlerësuar gjykata kushtetuese jo kushtetuese, pastaj ligji na vjen pa atë pjesë dhe ne shkojmë në procedura tjera të shqyrtimit dhe amendamentimit, dhe jo të bëhemi bashkëhartues me BQK-në .

Kryetarja: unë kisha mendue që është mirë se ne si komision për buxhet të merremi me këtë problematikë dhe të fillojmë me e bë zgjedhjen e problemit, i cili ka mbetur i pa zgjidhur. Ne si komision do ta kishim krye punën shumë më mirë me hartimin e këtij projektligji, se sa të lëmë hapësirë në forma tjera që të vijë projektligji.

Latif Gashi: unë kam informacione se BQK është duke punuar në këtë projektligj dhe jam dakord me znj. Hykmete mos të marrim ne iniciativën për hartimin e projektligjit. Megjithatë duhet filluar puna në hartimin e këtij projektligji, por është mirë me e pas para se me bë grupin punues një takim me Guvernatorin dhe të koordinohemi se çfarë kanë punuar ata dhe ata janë të thirrur për me u marr me këtë problematikë.

Naser Osmani: e kam parasysh këtë që e keni ngritur, por unë dhe kryetarja e kemi taku Guvernatorin , kemi një material të mirë në dorë, por qëllimi është që hartimi të shkoj përmes komisionit për buxhet dhe financa.

Kryetarja: propozoi që në grupin punues të jenë: Safete Hadergjonaj (kryesuese), Naser Osmani, Latif Gashi, Hykmete Bajrami dhe Xhevdet Neziraj.

Në bazë të propozimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri

Vendosi

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa, merr iniciativën për hartimin e Projektligjit për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.
- II. Caktohet grupi punues, me këtë përbërje: Safete Hadergjonaj (kryesuese), Naser Osmani, Latif Gashi, Hykmete Bajrami dhe Xhevdet Neziraj.

8.3. Kryetarja: njoftoi anëtarët se me 31.03.2014, në orën 12:00, në Universitetin e Prishtinës, do të mbahet një ligjëratë, pjesë e organizimit është GIZ, nga një eksperte që do të vije nga Vjena, Dr. Elizabeth, dhe kush ka mundësi me marr pjesë në këtë takim, do të ishte mirë.

8.4. Kryetarja: e kam edhe një njoftim që ka të bëjë me Projektligjin për Veteranët e UÇK-së, ku komisioni funksional në bazë të informatave që kam do ta përfundojë punën sot në amendamentimin e projektligjit dhe do ta marrim raportin me amendamente si komision kryesorë për të shqyrtuar. Për këtë qëllim i njoftoi anëtarët se nesër prej orës 9:00, do të mbahet një mbledhje e Komisionit, ku do të shqyrtohet vetëm kjo pikë : Shqyrtimi i Projektligjit për Veteranët e UÇK-së me amendamentet e komisionit funksional për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale, në mënyrë që ti jepet mundësia që projektligji të jetë pjesë e shqyrtimit në seancën plenare.

Mbledhja përfundoi: 12:00

Përqatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj